

L I G J
Nr.7919, datë 19.4.1995

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7574, DATË 24.6.1992 “PËR ORGANIZIMIN E DREJTËSISË DHE DISA NDRYSHIME NË KODET E PROCEDURAVE PENALE DHE CIVILE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Komisionit të Ligjeve,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7574, datë 24.6.1992 “Për organizimin e Drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale dhe Civile”, neni 19 ndryshohet si vijon:

“Gjyqtarët, ndihmësgjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit largohen nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë kur kryejnë një vepër penale, bëhen të paaftë nga ana shëndetësore, nuk fitojnë provimin periodik profesional si dhe kur janë të paaftë nga ana profesionale lidhur me bazueshmërinë e vendimeve të dhëna, ose kur për shkak të sjelljes së tyre bëhen të papërshtatshëm për të kryer detyrën”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1091, datë 4.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha